

## ABSTRAKTI

Administrata Publike është një nga organet më të rëndësishme të një vendi demokratik, dhe ku zhvillimi dhe demokratizimi i saj përcakton edhe shkallën e zhvillimit të parimit të demokracisë në vend, apo parimit të respektimit të shtetit të së drejtës. Administrata publike është organi ku marrin zgjidhje kërkesat e qytetarëve dhe në mënyrë qëadministrata të jetë sa më efikase ajo duhet të plotësojë disa kushte, dhe një ndër kushtet më kryesore për një administratë efikase është parimi i decentralizimit. Një administratë ku respektohet parimi i decentralizimit do të thotë një administratë e pavarur. Ky parim relativisht i ri vjen si domosdoshmëri e zhvillimit të mëtejshëm të shtetit demokratik, shtetit të së drejtës dhe standardeve që duhen plotësuar për t'iu bashkuar familjes së madhe evropiane.

Kushtetuta i rezervon parimit të decentralizimit një vend të rëndësishëm në përmbajtjen e saj, si domosdoshmëri për një administratë efikase dhe në shërbim të qytetarit. Por jo vetëm Kushtetuta, por edhe një sërë ligjesh e përforcojnë parimin se administrata publike duhet të jetë e pavarur. Ligji nr. 05/L-031“Për procedurën e përgjithshme administrative” është gjithashtu një garanci për një administratë efikase edhe të pavarur, dhe gjithashtu edhe një sërë aktesh të tjera ligjore, siç është ligji për “Vetëqeverisjen lokale në Kosovë”.

Punimi do të shqyrtojë rolin dhe funksionet që ka një administratë efikase, çfarë kriteresh duhet të plotësojë një administratë efikase dhe në çfarë mase e zbaton një administratë efikase parimin e decentralizimit.

Në fund studimi do të ofrojë përfundimet dhe rekomandimet për mënyrën sesi mund të rregullohet me ligj edhe më tej ky parim, në mënyrë që të kemi një administratë të pavarur dhe në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë.

**Fjalët kyçe:** *administratë publike, decentralizim, pavarësi, administratë efikase, administratë në funksion të qytetarit.*